

PKR.nr.525/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, gjykata e shkallës së parë penale, kryetarja e trupit gjykues, Suzana Çerkini me sekretaren juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurve A.C nga P, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 pika 3.2 lidhur me par. 2 dhe par. 1 pika 1.4 të KPRK, veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 të KPRK, si dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK dhe, S.I nga P, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.348/2016, të datës 20.09.2016, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 30.09.2016, me praninë e Prokurorit të shtetit Ferdane Sylejmani, të pandehurve A.C me mbrojtësin sipas autorizimit av. O.M dhe S.I me mbrojtësin sipas autorizimit, av. N.R, me datë 04.10.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

1. I pandehuri **A.C**, i biri i B, dhe nënës V e vajzërisë Q, i lindur me *data e lindjes*, në P ku edhe jeton rr.”...” pn, ka të kryer shkollën e mesme, punon kamarier, i martuar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,
2. I pandehuri **S.I**, i biri i I, dhe nënës H, e vajzërisë I, i lindur me *data e lindjes*, nga P, rr.”...”, nr. ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, babë i tre fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal *numri personal*,

-I-

JANË FAJTOR

I pandehuri **A.C**

I. Sepse, me datën 09.07.2016, rreth orës 09:00, në K T, në P, në shtëpinë e tij, me dashje që ti shkaktojë lëndime trupore të dëmtuarës C.G.D, shtetase rumune, bashkëshorte e tij, nxjerr dy armët e zjarrit me njëren nga to gjuan një herë, në mënyrë kërcënuese për t’a frikësuar të

dëmtuarën dhe me të dy armët me kondak e godet disa herë në kokë dhe, me mjete të forta e godet në pjesë të ndryshme të trupit, me çka i shkakton lëndime të lehta trupore,

- me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 pika 3.2 lidhur me par. 2 dhe par. 1 pika 1.4 të KPRK,

II. Sepse, në kohë, vend, mënyrë të përshkruar si në pikën I të dispozitivit, ka përdorur në mënyrë kërcënuese për ta frikësuar të dëmtuarën C.G.D, dy armë të zjarrit dhe atë, një pistoletë, të markës “TT”, e kalibrit 7.62 mm, me nr. serik N-159482, dhe një pistoletë të markës HS e kalibrit 9x19, me nr. serik H61532,

- me këtë ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 të KPRK,

I pandehuri Sami Ibishi

Sepse, në kohë, vend, mënyrë e përshkruar si në pikën I të dispozitivit, pa autorizim dhe pa leje paraprake ka mbajtur armë në posedim, ka shkuar në vendin e ngjarjes, ashtu që pas një kontrolli që ia bëjnë policia, te i njëjti e gjejnë armën e tipit “TT”, me nr. serik F-62408, e kalibrit 7.62 mm, dhe një karikator dhe 7 (shtatë) fishek, mbajtja e së cilës në posedim është në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm mbi armët,

- me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 7,17,21,41,45,46,73,75 par.1 pika 1.3, 76 pika 1.5 të KPRK dhe nenit 248 par.4, 365, 366 të KPP të KPP gjykata,

Të pandehurit A.C i shqipton,

DËNIM ME BURGIM

Për veprën penale nga **pika I e dispozitivit**, dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë), muaj, dhe**

DËNIM ME GJOBË DHE ME BURGIM

Për veprën penale nga **pika II e dispozitivit**, dënim me gjobë në shumë prej **1000 € (njëmijë) euro**, si dhe dënim burgimi në kohëzgjatje prej **3 (tre) muaj**,

Në bazë të nenit 80 par.2 pika 2.2 dhe 5 të KPP, të pandehurit i shqipton:

DËNIM UNIK ME BURG DHE ME GJOBË

Në kohëzgjatje prej **8 (tetë) muaj** dhe dënim me gjobë në shumë prej **1000 € (njëmijë) euro** i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

Në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPRK, për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, ndaj të pandehurit **A.C**,

-II-

REFUZOHET AKUZA

Sepse, në kohë, vend dhe mënyrë të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të parë, pa autorizim dhe pa leje paraprake, ka mbajtur në posedim dy armë të zjarrit dhe atë një pistoletë, të markës “TT”, e kalibrit 7.62 mm, me nr. serik N-159482, dhe tjetra pistoletë e markës HS e kalibrit 9x19, me nr. serik H61532, mbajtja e të cilave në posedim është në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm mbi armët,

- me çka kishte për të kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK
- Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza,

Të pandehurit S.I i shqipton,

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **600 € (gjashtëqind) euro**, të cilin dënim obligohet t'a paguajë brenda afatit prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

Nëse të pandehurit nuk i paguajnë gjrobat e shqiptuara, gjykata do t'ua zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do t'i llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë,

Ndaj të pandehurit A.C, **NDËRPREHET** menjëherë masa e paraburgimit,

Të pandehurit A.C, koha e kaluar në paraburgim nga data 09.07.2016 deri me datë 04.10.2016 do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar,

Secilit të pandehuri, komfor nenit komfor neneve 62 par.2 pika 2.6 dhe nenit 69 të KPRK dhe nenit 248 par.4 të KPP gjykata i shqipton,

DËNIM PLOTËSUES

Nga i pandehuri **A.C**

Konfiskohet: një Pistoletë e markës TT", e kalibrit 7.62 mm, me nr. serik N-159482, një karikator, katër fishekë të kalibrit 7.62 mm, një pistoletë të markës HS e kalibrit 9x19, me nr. serik H61534, një karikator, pesë fishekë të kalibrit 9 mm si dhe një gëzhjojë, të precizuara në vërtetimin e bashkangjitur në shkresa të lëndës, mbi marrjen e përkohshme të sendeve Nr.2016-AC-0832, të datës 09.07.2016,

Nga i pandehuri **S.I**

Konfiskohet: një pistoletë e markës TT", me nr. serik F-62408, e kalibrit 7.62 mm, dhe një karikator dhe 7 (shtatë) fishek të kalibrit 7.62 mm, një briskë ngjyrë e gjelbërt Army, të precizuara në vërtetimin e bashkangjitur në shkresa të lëndës, mbi marrjen e përkohshme të sendeve Nr.2016-AC-0832, të datës 09.07.2016,

Të pandehurit secili veç e veç, obligohen t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor do të paguajnë secili shumë prej nga 50 € (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën PP.nr.348/2016 të datës 20.09.2016, ka akuzuar të pandehurin A.C nga P, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 pika 3.2 lidhur me par. 2 dhe par. 1 pika 1.4 të KPRK, veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 të KPRK, si dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, si dhe të pandehurin S.I nga P, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas adminsitrimnit të provave në shqyrtim gjyqësor, të pandehurit t'i shpall fajtor dhe t'i dënojë sipas ligjit.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti seancë të shqyrtimit fillestar me datë 30.09.2016, në të cilën të pandehurit A.C dhe S.I, në prani të mbrojtësve të tyre, të vënë në dijeni të plotë për natyrën dhe pasojat e pranimnit të fajësisë, vullnetarisht pranuan fajësinë për veprat penale që u vihen në barrë me aktakuzë, për çka i pandehuri A.C, kërkoi falje për atë çfarë ka ndodhur, gjithashtu edhe i pandehuri S.I, shprehu keqardhje për veprën penale të kryer.

Mbrojtësi i të pandehurit A.C, av. O.M, deklaroi se pas konsultimit të mjaftueshëm me të mbrojturin e tij, duke i treguar për benefitet që do t'i ketë me rastin e pranimnit të fajsis, i njëjti në mënyrë vullnetare pranoi fajësinë, duke theksuar se është penduar thellë për veprat që i ka kryer, ka thënë se ka qenë i dehur dhe për këtë ka kërkuar falje publike. Në vazhdim mbrojtësi ka kërkuar nga gjykata që gjatë matjes së dënimit, të ketë parasysh rrethanat lehtësuese, se është familjar, i martuar, ka dy fëmijë të mitur, shprehjen e dëshirës së bashkëshortes së tij që posa të dal i pandehuri në liri, të shkojë në ofiqari dhe të kurorëzohet me të pandehurin, faktin se për herë të parë i njëjti ka rënë ndesh me ligjin, sjelljen e tij korrekte në prokurori dhe në gjykatë, si dhe deklarinin me sinqeritetin më të madh se është penduar dhe se nuk do të kryej vepër tjetër penale. Në fund i propozon gjykatës që të mbrojturit të tij t'i shqiptojë dënim me gjobë apo me kusht duke marrë për bazë kushtet për zbutje të dënimit, meqë edhe e dëmtuara ka deklaruar se kjo ka qenë hera e parë që bashkshorti i ka shkaktuar lëndime, se të njëjtit ia fal gabimin dhe se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Mbrojtësi i të pandehurit S.I, av. N.R, lidhur me fajësinë deklaroi se e mbështet në tërësi deklarinin e të mbrojturit të tij, i cili deklarim vjen pas konsultimit të mjaftueshëm me të dhe, njëkohësisht theksoi se i njëjti është penduar thellë për veprimet që i ka ndërmarë dhe se nuk do të përsërisë më veprime të tilla. Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit sa i përket të pandehurit S.I, ka propozuar gjykatës që ta ketë parasysh sinqeritetin e tij që nga dita e parë e tij në polici dhe qëndrimin e tij korrekt gjatë gjithë kësaj procedure dhe, gjitha rrethanat lehtësuese që mund të parashihen me ligj e të cilat njëkohësisht mund të përshtaten personalitetit të S, pra, kërkoi nga gjykata që t'i shqiptojë një dënim sa më të butë, mundësisht dënim me gjobë, duke pasur parasysh

se S vuan nga një sëmundje nga zemra dhe poashtu është baba i tre fëmijëve për të cilët duhet të përkujdeset.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit deklaroi se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit A, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare duke respektuar të gjitha dispozitat e KPP, ndërsa sa i përket pikës III që ka të bëjë me A.C për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, ka hequr dorë nga ndjekja e mëtejme penale, edhe pse i pandehuri veç e pranoi fajsinë, por arsyeja e heqjes dorë theksoi se është fakti se i pandehuri, të njëjtat armë që i ka mbajtur pa leje edhe i ka përdorur dhe, këtë e pranon vullnetarisht, kështu që më tej ka shtuar se mbetet pranë pikës I dhe II të aktakuzës, ashtu siç i ka pranuar i pandehuri A.C. Sa i përket pranimin të fajësisë nga i pandehuri S.I, theksoi se gjithashtu pajtohet me pranimin i fajësisë nga ana e të njëjtit, meqë pranimi është bërë konform dispozitave të KPP, andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovojë.

Gjykata dëgjoi edhe të dëmtuaren, bashkëshorten e të pandehurit A.C, C.G.D, shtetase rumune, e cila i ka deklaruar gjykatës se ka dy fëmijë me A, jetojnë bashkë qe tetë vjet, nuk kanë pasur problem më herët, A nuk e ka rrahur më parë, ajo mendon që të vazhdojë të jetojë sërish me A, ndihet e sigurt dhe e don të A, e ka burrë dhe se ia ka falur gabimin. Si rrjedhim i deklarimit të dëshmitares në mënyrë shprehimore se nuk dëshiron kurrfarë kompensimi për dëmin që ia kishte shkaktuar bashkëshorti i saj A.C, gjykata të njëjtën nuk e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko-civil.

Pas deklarimit të dy t'pandehurve A.C dhe S.I se ndihen fajtor për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohen dhe, pajtimit të prokurorit për pranimin e fajësisë për të pandehurin A.C për pikën I dhe II të aktakuzës dhe për të pandehurin S.I për pikën IV të aktakuzës, gjykata gjithashtu e aprovoi pranimin e fajësinë nga të pandehurit, pasi është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe se, ky pranim është bërë vullnetarisht dhe i mbështetur në faktet e çështjes që i përmban aktakuza.

Gjykata, pas aprovimit të pranimin të fajësisë nga të pandehurit A.C dhe S.I si dhe pas vlerësimit të rrethanave të rastit, konstatoi gjendjen e fakteve që e përmbanë akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të pandehurve, ekzistojnë elementet e veprave penale të përshkruara si në dispozitivet e aktgjykimit, andaj pasi që më parë gjeti se të pandehurit janë penalisht përgjegjës, të njëjtit i shpalli fajtor për veprat penale që u vihen në barrë, dhe u shqiptoi dënim të paraparë ligjor.

Me rastin e përcakimit të vendimit mbi dënimin ndaj të pandehurve, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si, rrethanat lehtësuese, për të pandehurit, pranimin e fajësisë gjatë seancës fillestare, keqardhjen për veprën e kryer, premtimin se nuk do të përsërisin vepra të tilla, e poashtu edhe faktin se në bazën e shënimeve në gjykatë, nuk evidentohet asnjëri i pandehur si kryes i ndonjë veprave penale, të natyrës së tillë tillë apo të ngjashme, për të pandehurin A.C pati parasysh gjithashtu faktin se bashkëshortja e tij

shprehimisht theksoi se e don A, se ia fal gabimin dhe se ndihet e sigurt për të vazhduar jetën me A, ndërsa rrethanë veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti tek të pandehurit, andaj secilit veç e veç i shqiptoi dënimet e precizuara si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se dënimet e tilla i përgjigjen peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të secilit t'pandehur, se ky dënim do të ndikojë në resocializimin e të njëjtëve, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK dhe në fund, me bindje se të pandehurit në të ardhmen nuk do të përsërisin vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin për llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim për të pandehurin A.C, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 83 par.1 të KPRK.

Vendimin për konfiskimin e sendeve, të armëve dhe gjëseneve të tjera, të mbajtura, përkatësisht të përdorura në mënyrë të paautorizuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 69 lidhur me me nenin 375 par.3 të KPRK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.525/16, me datë 04.10.2016**

**Sekretarja juridike
Ardita Azemi**

**Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja,
Suzana Çerkini**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.